Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "F&L Group shpk" të datës 09.10.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve në hapësira gjelbëruese dhe shndërrimi i oborreve të shkollave në parqe të qasshme - Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-7377-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "F&L Group shpk" të datës 09.10.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve në hapësira gjelbëruese dhe shndërrimi i oborreve të shkollave në parqe të qasshme - Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-7377-5-2-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "F&L Group shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 09.10.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parqeve në hapësira gjelbëruese dhe shndërrimi i oborreve të shkollave në parqe të qasshme - Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-7377-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

*"**Pretendimi nr. 1:** AK në paramasë konkretisht në pozicionin nr. 1 ka përcaktuar kërkesë si vijon "Matja dhe shenjëzimi gjeodezik i lokacionit dhe punimeve të ekzekutuara". Ndërsa si njësi matëse për këtë pozicion ka përcaktuar "KOMPLET".*

Matjet dhe shenjëzimi gjeodezik aplikohet në sipërfaqe. Ndërsa sipërfaqja matet me "m2" dhe jo me "komplet". Me fjalë të tjera njësia matëse për këtë pozicion është përcaktuar gabimisht. Vlen të theksohet po ashtu fakti që edhe çmimi për realizimin e një pozicioni të tillë për matje dhe shenjëzim gjeodezik, është i lidhur ekskluzivisht me sipërfaqen në të cilën aplikohet. Pra sa më e madhe sipërfaqja, aq më i lartë është çmimi për matje/shenjëzim gjeodezik dhe anasjelltas, sa më e vogël sipërfaqja, aq më i ulët do të jetë çmimi. Për këto arsye, AK duhet të korrigjoj njësinë matëse në poz. 1 të paramasës në m2.

***Pretendimi nr. 2:** AK në paramasë konkretisht në pozicionin nr. 5 ka përcaktuar kërkesë si vijon "Furnizimi, transporti dhe aplikimi i betonit C25/30". Në këtë pozicion është paraparë furnizimi, transporti dhe aplikimi i rrjetën e armaturës Ø8 mm, me dimensione 6m x 2m, ndërsa sipas përshkrimit teknik trashësia e pllakës së betonit është përcaktuar prej deri në 15 cm. Sasia e përcaktuar në paramasë është 500m3.*

Cmimet aktuale të tregut për 1m3 beton sillen nga 86 euro deri në 92 euro. Ndërsa një rrjetë e armaturës Ø8mm me dimensione 6mx2m sillen nga 38euro deri në 41 euro.

Pra vetëm kosto e materialit (betonit dhe armaturës) për realizimin e këtij pozicioni është rreth 57,250.00 euro. Nëse kësaj vlere i shtojmë edhe kostot e operimit sic janë puna e dorës, humbjet e materialit gjatë aplikimit, por edhe TVSH dhe tatimet tjera, atëherë kosto për realizimin e këtij pozicioni arrin në vlerën rreth 86,500.00 euro. Në këtë shumë, nuk kalkulohen fitimet e kompanisë por vetëm kostot e domosdoshme të realizimit. Nëse marrim parasysh që vlera totale e parashikuar për këtë aktivitet është vetëm 150,000.00 euro, atëherë rreth 57,66% e kësaj vlere do të shpenzohet vetëm për të realizuar këtë pozicion, pa e përfshirë këtu asnjë përfitim për kompaninë. Natyrisht që nëse kjo do të lejohet që të ndodhë nga AK, pozicionet tjera nuk do të mund të realizohen asnjëherë dhe ky projekt destinohet për të dështuar.

Përtej pamundësisë financiare, edhe zbatimit praktik i këtij pozicioni është shumë kundërthënës. Kjo kundërthënie mund të shpjegohet matematikisht shumë thjeshtë.

Fillimisht, 500m3 nëse aplikohen në një pllakë prej 0.15m trashësi sikurse është kërkuar nga AK, atëherë kjo nënkupton që sipërfaqja totale e pllakave që duhet të aplikohen është rreth 3,333.33m2. Ky aktivitet është për ndërtimin e parqeve dhe jo për ndërtimin e stadiumeve. Pra është e pamundur të paramendohet ndërtimi i një parku rreth 3,333.33 m2 komplet në beton dhe armaturë.

Nëse rrjetat e armaturës kanë dimensioned 6m x 2m kjo nënkupton që dimensioned e pllakës janë 12m2. Nëse trashësia e pllakës është 15cm apo 0.15m, kjo nënkupton që në tërësi një pllakë e betonit me armaturë do të ketë sipërfaqe rreth 1.8m3. Nëse në paramasë janë kërkuar 500m3 në total, kjo nënkupton që AK do të kërkojë aplikimin e rreth 277 pllaka të tilla (sepse 500:1.8=277.77). Pyetja hipotetike që shtrohet është se ku do të vendosen të gjitha këto pllaka? Në gjithë Komunën e Prishtinës nuk ekzistojnë 277 shkolla prandaj edhe në aspektin operativ është e pamundur që të aplikohet ky pozicion dhe shpjegimi matematikor si më sipër është argumenti i pakontestueshëm për këtë fakt.

Për këtë aktivitet të prokurimit, AK nuk ka publikuar ndonjë plan të detajuar. Megjithatë të thënat më sipër do të mund të rikonfirmohen lehtësisht vetëm nga analiza e terrenit, përtej argumentimit logjik, matematikor dhe financiar.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Nga sa u tha më sipër kërkojmë nga AK që të optimizojë sasinë e kërkuar për këtë pozicion në maksimum 150m3 të cilat janë më shumë se të mjaftueshme për të realizuar këtë projekt, mbi bazën e vlerës së parashikuar nga vet AK.

Pretendimi nr. 3: *AK në poz. 9 ka përcaktuar si vijon "Furnizimi dhe rregullimi me mulch dekorativ". Sasia e parashikuar për këtë pozicion është 100m3 ndërsa trashësia e shtresës së mulchit kërkohet të jetë rreth 10cm.*

Nëse trashësia është 10cm apo 0.1m ndërsa sasia e përgjithshme është 100m3, atëherë kjo nënkupton që sipërfaqja në të cilën do të aplikohet mulchi është 2,000m2.

Në këtë pozicion është paraparë furnizimi dhe aplikimi i 100 m³ mulch dekorativ.

Duke marrë parasysh natyrën e materialit dhe përdorimin e tij për mbulimin dekorativ të sipërfaqeve të gjelbëruara, konsiderojmë se sasia e paraparë është e konsiderueshme dhe kërkon sqarim lidhur me sipërfaqet dhe trashësinë e shtresës së projektuar.

Për ilustrim, në rast se materiali aplikohet me trashësi 10 cm, sasia prej 100 m³. korrespondon me një sipërfaqe prej rreth 1,000 m², ndërsa me trashësi 5 cm korrespondon me rreth 2,000 m².

Çmimi aktual për 1m3 është nga 80 deri në 120 euro. Kjo nënkupton që kosto për realizimin e këtij pozicioni është rreth 10,000.00 euro. Nëse marrim parasysh kompleksitetin e projektit dhe vlerën e ulët të buxhetit të parashikuar, sipërfaqja e kërkuar për aplikimin e mulchit prej 100m3 është jo vetëm financiarisht e pakuptimitë por edhe praktikisht e palogjikshme sepse AK nuk ka se ku të aplikojë 2,000 m2 të mulchit.

Pretendimi nr. 1 miratohet si i bazuar dhe ndryshohet njësia nga "komplet" në "m²".

Pretendimi nr. 2 miratohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet sasia nga 500 në 40.

Pretendimi nr. 3 miratohet si pjesërisht i bazuar dhe ndryshohet sasia nga 100 në 40.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".*

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.10.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net